



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Kushtet në qendrat e paraburgimit në Kosovë

Vlerësimi i parë

Dhjetor 2010

Pasqyra e përbajtjes

I. Hyrje	3
II. Metodologja	4
III. Standardet relevante të të drejtave të njeriut	5
1. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	5
2. Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	6
a) <i>Kushtet materiale në qeli</i>	7
b) <i>Higjiena</i>	8
c) <i>Ushqimi dhe uji</i>	8
d) <i>Shërbimet mjekësore</i>	8
e) <i>Regjimi i duhur i aktiviteteve</i>	9
f) <i>Disiplina dhe Ndëshkimet</i>	10
g) <i>Ankesat</i>	11
IV. Vlerësimi	11
1. Faza e parë: vizitat njohëse	11
2. Faza e dytë: Vlerësimi i kushteve materiale në objektet e paraburgimit	12
2.1 Kushtet fizike në qeli	12
2.2 Ushqimi dhe uji	16
2.3 Bibliotekat	16
2.4 Vendet e hapura për ushtrime	17
2.5 Kushtet e punës së personelit.....	17
V. Perspektivat	17
1. Projekti i OSBE-së për monitorimin e paraburgimit i vendosur në perspektivë	17
2. Qasja	18
3. Krijimi i një sistemi të institucionalizuar të vizitave në Kosovë	18
VI. Konkudime dhe rekondime	19
1. Kushtet Materiale	20
2. Monitorimi i Paraburgimit	20
VII. Shtojca	22
1. Tabela e objekteve të paraburgimit.....	22
2. Tabela e paraburgimit, qelitë individuale	23

I. Hyrje

Që nga themelimi i tij, Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (OSBE) ka monitoruar gjendjen e të drejtave të njeriut dhe ka vlerësuar disponueshmërinë dhe efektshmërinë e mjeteve juridike të vendosura në Kosovë për të siguruar korrigimin e shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut.¹ Mangësitë e identifikuara përmes programeve monitoruese të OSBE-së janë adresuar tek institucionet përgjegjëse për veprimet e duhura korrigjuese, duke synuar arritjen e përputhshmërisë me standartet e të drejtave të njeriut.

Qysh prej vitit 2001, OSBE-ja ka qenë e angazhuar në monitorimin e agjencive të zbatimit të ligjit në Kosovë, me fokus në policiinë, duke i këshilluar institucionet gjegjëse dhe palët e përfshira në standartet e zbatuara të të drejtave të njeriut.² Aktivitetet e OSBE-së në vëzhgimin dhe vlerësimin gjithëpërfshirës kanë për qëllim të shërbejnë si vegla për institucionet gjegjëse që t'i korrigojnë dobësitë e mundshme prej së brendshmi. Në këtë fushë të veçantë të vëzhgimit të agjencive të zbatimit të ligjit, OSBE-ja trajton mungesat institucionale dhe ligjore përmes raportimit jo-publik, që i drejtohet vetëm institacioneve të identifikuara lokale.³ Për shembull, raportet që dalin nga vëzhgimi i objekteve të paraburgimit i drejtohen Ministrit të Drejtësisë dhe Komesarit të Shërbimit Korrektues (Komesari). Pasi që OSBE-ja synon të ketë ndikim konkret përmes aktiviteteve të saj, raportet jo vetëm identifikojnë mungesat, por edhe japid rekomandime konkrete dhe praktike mbi atë se si duhen korriguar ato. Është e rëndësishme të theksohet që në të kryerit e kësaj pune, OSBE-ja ndjek një qasje bashkëpunuese, e jo antagoniste.

Kjo qasje bashkëpunuese e OSBE-së mundëson kombinim të vëzhgimeve, raportimeve jo-publike, këshillimeve dhe kryerjes së projekteve përcjellëse si punëtoritë për të diskutuar mungesat e identifikuara me institucionet gjegjëse. Raportet e pavarura dhe jo-publike të OSBE-së mund të shërbejnë, *inter alia*, si vegël për shërbimin korrektues të Kosovës si dhe Ministrinë e Drejtësisë për të térhequr financimin nga donatorët.

Ky rapport është vlerësimi i parë, i përgjithësuar i OSBE-së për kushtet e objekteve të paraburgimit në tërë Kosovën, me fokus në përputhshmërinë me të drejtat e njeriut. Gjatë vëzhgimit, OSBE-ja i ka vlerësuar kushtet materiale në objektet e paraburgimit, sidomos në lidhje me çështjet si madhësia e qelive dhe mbingarkesa e tyre, ndriçimi, ventilimi, kushtet sanitare, hapësirat e jashtme të ushtrimeve, tualetet dhe dushet, mes tjerash. Në përgjithësi, kushtet e objekteve të paraburgimit janë të kënaqshme. Megjithatë, mungesa e hapësirës dhe mbingarkesa janë çështje që duhen zgjidhur në disa objekte paraburgimi. Çështje tjera që janë brengosëse mund të janë ndriçimi i paktë natyror dhe qarkullimi i ajrit në disa qeli, tualetet dhe dushet në gjendje të dobët, si dhe hapësirat e jashtme të ushtrimeve në disa qendra paraburgimi.

¹ Shih Nenin 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj): “Secili, të drejtat dhe liritë e të cilit garantohen me këtë Konventë, do të kenë mjete efektive juridike në autoritetet vendore, pa marrë parasysh nëse shkelja është bërë nga personat që veprojnë në pozita zyrtare.”

² Departamenti i OSBE-së për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Sektori i Monitorimit të Sigurisë, është në krye të këtij programi monitorues.

³ Aktivitetet e OSBE-së çojnë në ndikime konkrete, si renovimi i dhomave të ndalimit policor pas katër vlerësimëve gjithëpërfshirëse të kushteve në ato qeli. Policia gjithashtu ka shfrytëzuar këto vlerësimë objektive dhe të pavarura, duke përfshirë një tabelë që krahason gjendjen aktuale në qeli me standartet ndërkombëtare, si vegël për térheqjen e fondeve donatore për riparimin e dhomave të ndalimit.

Ky rapport gjithashtu prek çështje tjera, si qasja në objekte të paraburgimit, si dhe perspektivën në lidhje me vëzhgimin e paraburgimit në të ardhmen në Kosovë, pra rëndësinë e inkurajimit të krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm inspektues vendor.

Me kërkesën e Komesarit, OSBE-ja do t'a bëj këtë raport publik. OSBE-ja e përgëzon këtë vendim pasi që e rrit ndikimin e këtij reporti dhe mundëson diskutimet konstruktive të tërthorta organizacionale se si të përmirësohen të metat e mundshme.

II. Metodologja

Në implementimin e programit të monitorimit të paraburgimit, OSBE-ja ka aplikuar një qasje hap pas hapi, në bazë të Kushteve të Referimit, të cilat i janë dorëzuar Komesarit në shkurt të vitit 2009. Gjatë vlerësimit, OSBE-ja ka krahasuar gjendjen aktuale të objekteve me standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në fazën e parë, OSBE-ja ka bërë vizita njoftuese tek Komisari dhe organet drejtuese të qendrave të paraburgimit në tërë Kosovën. Këto vizita fillestare u përqendruan në kushtet në qeli si dhe në tërë objektin në përgjithësi. Vlerësimet janë bërë jo vetëm në lidhje me qendrat si të tillë, por edhe në lidhje me reportin personel-të paraburgosur, duke përfshirë personelin e uniformuar dhe pjesëtarët tjerë, siç janë mjekët. Për shkaqe praktike, nuk ka qenë e mundur që në këtë fazë të shikohen kushtet në një numër më të madh qelish. Kështu, është vlerësuar një numër i vogël i qelive në secilin objekt.

Duke u bazuar pjesërisht në rezultatet e fazës së parë, u hartuan pyetësorë dhe tabela për të ndërtuar një vlerësim sistematik të qendrave të shërbimit korrektues. Në këtë fazë, stafi i OSBE-së në terren ka vendosur kontakte me organet drejtuese të qendrave të paraburgimit në zonën e tyre të përgjegjësisë.⁴ Gjatë të gjitha fazave, stafi i OSBE-së ka punuar në konsultim të afërt me Komisarin dhe/ose personelin e tij, në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave.

Në përfundim të fazës së dytë, OSBE-ja hartozi këtë raport për Ministrin e Drejtësisë dhe Komisarin. Për qëllime praktike, rezultatet e fazës së parë dhe asaj të dytë janë përbashkuar në një raport të vetëm.

Draft rapporti është diskutuar me Shërbimin Korrektues të Kosovës gjatë punëtorisë së organizuar me 24 Shtator 2010. Drejtorët e qendrave, e poashtu edhe Komesari u pajtuan në përgjithësi me të gjeturat e OSBE-së, dhe japën informata më të freskëta rreth renovimeve të fundit. Si rrjedhojë e punëtorisë, në Tetor të vitit 2010, OSBE-ja i vërtetoi këto informata më të reja të japura nga stafi i shërbimit korrektues. Këto të dhëna më të reja janë të reflektuara edhe në këtë raport.

Në mënyrë që të përcillen rekomandimet, OSBE-ja periodikisht do të ri-vëzhgojë situatën, për t'i shënuar ndryshimet dhe përmirësimet e mundshme në Shërbimin Korrektues, si dhe të hartoje një vlerësim të sërishtëm. Përveç kësaj, OSBE-ja parashikon hartimin e një raporti për të drejtat e të paraburgosurve.⁵

⁴ Personeli i Sektorit të OSBE-së për Monitorimin e Sigurisë në terren është i vendosur në gjashtë rajonet e policisë në Kosovë, gjegjësisht në Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gniljane, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, dhe Prizren.

⁵ Aktivitetet e Sektorit të OSBE-së për Monitorimin e Sigurisë nuk mbulojnë të drejtat e personave të arrestuar në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë. Kjo çështje mbulohet nga Sektori i OSBE-së për Monitorim të

III. Standardet relevante të të drejtave të njeriut

1. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Të drejtat e të paraburgosurve janë të mbrojtura me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Neni 10(1) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) bën referencë specifike ndaj të paraburgosurve: “të [g]jithë personat e privuar nga liria e tyre do të trajtohen me njerëzi dhe respekt për dinjitetin e pandashëm të qenies njerëzore”. Neni 10(3) i ICCPR-së parashikon më tutje që “[s]istemi ndëshkimore do të përfshijë trajtimin e të burgosurve, synimi qenësor i të cilit do të jetë reformimi dhe rehabilitimi i tyre social”.

Veç kësaj, instrumentet ndërkombëtare për të drejta të njeriut e ndalojnë në mënyrë absolute torturën dhe keqtrajtimet tjera. Neni 5 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) thekson që “[a]skush nuk do t’i nënshtrohet torturës apo dënimive apo trajtimit të vrazhdë, çnjerëzor apo degradues”. Neni 3 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) si dhe neni 7 i ICCPR-së e ritheksojnë këtë kërkesë. Për më shumë, instrumentet specifike që mëtojnë të parandalojnë torturën dhe trajtimet e dënimet degraduese janë krijuar nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Këshillit të Evropës, gjegjësisht Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimit e Dënit të vrazhdë, çnjerëzor dhe degradues, si dhe Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit e Dënit Çnjerëzor apo Degradues (ECPT).

Për shkak të faktit që të paraburgosurit janë të privuar nga liria dhe kontrolli i tyre mbi natyrën e veçantë të mjedisit të tyre jetësor, ata janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj trajtimit të vrazhdë, çnjerëzor apo degradues. Keqtrajtimi i të paraburgosurve mund të ketë shumë forma, si keqtrajtimi mendor dhe fizik nga personeli i burgut apo të burgosurit tjerë, apo eksposimi i tyre në kushte të dobëta materiale.

Megjithatë, dispozitat e këtyre instrumenteve ndërkombëtare janë shumë të përgjithshme dhe nuk përcaktojnë standarde specifike në lidhje me trajtimin e të paraburgosurve. Kështu, OKB-ja dhe Këshilli i Evropës kanë themeluar standarde për trajtimin e të burgosurve në bazë të dispozitave të ligjit të butë, të cilat janë autoritative.

OSBE-ja referohet tek Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat Standarde Minimale të OKB-së) si dhe Rregullat Evropiane të Burgut. Rregullat Standarde Minimale të OKB-së janë miratuar në vitet e 50-ta, duke synuar të “përcaktojnë atë që gjërisht pranohet si parim dhe praktikë e mirë në trajtimin e të burgosurve dhe menaxhimin e institacioneve.”⁶ Rregullat Evropiane të Burgut, të miratuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 12 shkurt 1987, janë standard i përgjithshëm rajonal që parashikon udhëzimet për shërbimet e burgut, mbi atë se si të sigurohet përputhshmëria me të drejtat e njeriut në objektet e tyre. Derisa Rregullat Standarde Minimale të OKB-së nuk janë ndryshuar qysh prej miratimit të tyre, Rregullat Evropiane të Burgut janë azhurnuar më 2006 “për t’i pasqyruar zhvillimet që janë bërë në politikat penale, praktikat e dënit dhe menaxhimin e përgjithshëm të burgjeve në Evrop.”⁷

Sistemit Ligjor, i cili gjithashtu ka lëshuar raportet e tij publike në nëntor 2009 (Pjesën 1) dhe mars 2010 (pjesën 2) mbi “Shfrytëzimin e paraburgimit në procedura penale në Kosovë: Shqyrtim gjithëpërfshirës dhe analizë e brengave të pranishme.”

⁶ Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve, paragrafi 1.

⁷ Rekomandimi Rec(2006)2 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgut.

OSBE-ja gjithashtu mbështetet në punën e Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT).⁸ Në përgjithësi, KPT-ja ka prodhuar tërësinë më gjithëpërfshirëse të punës në lidhje me monitorimin e burgjeve, dhomave të ndalimit policor, si dhe institucioneve shtetërore (p.sh. institucionet e shëndetit mendor, institucionet e korrektimit të të miturve). Raportet e KPT-së për vende paraqesin udhëzime shumë të dobishme në vlerësimin e përputhshmërisë së objekteve të paraburgimit me standarde ekzistuese ndërkombëtare. Në gusht të vitit 2004, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së nënshkroi një marrëveshje teknike në lidhje me KEPT-në me Këshillin e Evropës, sipas të cilës KPT-ja mund të organizojë vizita në Kosovë për të hulumtuar trajtimin e personave të privuar nga liria. Kjo i jep KPT-së mundësinë të vizitojë Kosovën dhe të vlerësojë vendet e paraburgimit.⁹ Raportet e KPT-së kanë status mjaft autoritativ dhe gjëzojnë mbulim të gjerë mediatik. Këto inkurajojnë diskutime mbi të drejtat e njeriut dhe paraburgimin, gjë që zakonisht nuk janë çështje e opinionit publik. Raporti i KPT-së pas vizitës së tyre në Kosovë më 2007 dhe reagimi i UNMIK-ut janë diskutuar gjërësisht në mediat lokale. Kështu, roli i KPT-së në Kosovë, si i vetmi trup i jashtëm që viziton dhe vlerëson objektet e burgimit, nuk mund të mbivlerësohet.

Siqë është përmendur më lart, ndalimi i torturës, trajtimi çnjerëzor apo degradues nuk vlen vetëm për abuzimin mendor dhe fizik, por edhe për kushtet fizike në objektet e paraburgimit. Sipas KPT-së, eksposizimi i tejzgjatur ndaj kushteve të dobëta materiale, si mbingarkesa, kushtet joadekuante sanitare dhe regjimet e dobëta të aktiviteteve, mund të janë të dëmshme për të burgosurit.¹⁰ KPT-ja gjithashtu ka vërejtur që maltretimi merr forma të shumta, “shumë prej të cilave mund të mos janë të qëllimshme, por më shumë rezultat i dështimeve organizative apo resurseve të pamjaftueshme.”¹¹

2. Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka nxjerrë disa aktgjykime kyçë mbi kushtet materiale në objekte paraburgimi. Ashtu si KPT-ja, GJEDNJ-ja ka theksuar se eksposizimi në kushte të dobëta materiale mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe degradues, pra shkelje të Nenit 3 të KEDNJ-së. Për shembull, në rastin *Peers kundër Greqisë*, GJEDNJ-ja ka vendosur që mbyllja e parashtruesit në një qeli të ngushtë pa ventilim apo dritare, ku atij i duhej të përdorte tualetin në prani të një të burgosuri tjetër, si dhe të ishte i pranishëm derisa tualeti përdorej nga i burgosuri tjetër, përbënte trajtim degradues.¹² Gjithashtu, në rastin *Kalashnikov kundër Rusicë*, GJEDNJ-ja gjeti që “kushtet e paraburgimit të parashtruesit, në veçanti mjedisi i mbipopulluar dhe aspak sanitar, si dhe ndikimi i tij dëmtues në shëndetin dhe mirëqenien e parashtruesit, kombinuar me kohëzgjatjen e periudhës gjatë të cilës parashtruesi është mbajtur në kushte të tilla, përbënte trajtim degradues.”¹³

⁸ Komiteti për Parandalimin e Torturës është themeluar sipas Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit e dënimit çnjerëzor dhe degradues (1987) për të hulumtuar trajtimin e personave të privuar nga liria.

⁹ Marrëveshja mes Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Këshillit të Evropës për rregullimin teknik në lidhje me Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit e dënimit çnjerëzor dhe degradues, Prishtinë/Priština, 23 gusht 2004. Vizita e fundit vlerësuese e Komitetit për Parandalim të Torturës në Kosovë është bërë në mars të vitit 2007.

¹⁰ Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti i Dytë Gjeneral [CPT/Inf (92)3], paragrafi 50, 13 prill 1992.

¹¹ Ibid, paragrafi 44.

¹² Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, *Peers kundër Greqisë*, Kërkesa nr. 28524/95, 19 prill 2001, paragrafi 75.

¹³ Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, *Kalashnikov kundër Rusicë*, Kërkesa nr. 47095/99, 15 korrik 2002, paragrafi 102.

GJEDNJ-ja gjithashtu ka gjetur që burgjet duhen organizuar në atë mënyrë që të sigurojnë “respektimin e dinjitetit të të burgosurve, pa marrë parasysh vështirësitë financiare apo logistike.”¹⁴ Ngjashëm, Rregullat Evropiane për Burgjet parashikojnë që “[k]ushtet e burgut që shkelin të drejtat njerëzore të të burgosurve nuk arsyetohen me mungesë resursesh”.¹⁵ Kështu, mungesa e mjeteve financiare për të përmirësuar kushtet e përgjithshme të paraburgimit nuk mund të arsyetojë kushtet që përbëjnë trajtim çnjerëzor apo degradues.

Standardet ndërkontrolluese për kushtet materiale në qeli, higjienën, ushqimin dhe ujin, shërbimet mjekësore dhe regjimin e duhur të aktiviteteve, disiplinën dhe ndëshkimet dhe ankesat do të shqyrtohen më në hollësi më poshtë.

a) *Kushtet materiale në qeli*

KPT-ja siguron një përbledhje të mirë për standardet e pranueshme në qeli: KPT-ja ka theksuar që:

[...] qelitë duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme jetese për të burgosurit ku ata mund të akomodohen, duhet të përfitojnë nga qasja në ndriçim natyror dhe ajrim dhe duhet të jenë të pajisura me ndriçim të mjaftueshëm artificial dhe ngrohje. Mjetet sanitare duhet t'u mundësojnë të paraburgosurve kryerjen e nevojave personale në kushte të pastra dhe të përshtatshme; ose duhet të instalohet një vaskë në hapësirën e qelisë (mundësish në një aneks sanitari) ose mjetet duhet të ekzistojnë ashtu që ju mundësojnë të paraburgosurve, që duhet të lëshojnë qelinë e tyre, përdorimin e vaskës pa vonesa gjatë tërë kohës, përfshirë natën. Është e dëshirueshme të ketë ujë brenda qelisë dhe që të paraburgosurit të kenë qasje të duhur në dush apo hapësirat e banjës. Qelitë duhet të jenë të mobiluara mirë (krevat, tavolinë, karrige/stol dhe sirtar) dhe të gjitha hapësirat/pajisjet duhet të jenë në gjendje të mirë për riparim dhe të paraburgosurit duhet të vendosen në pozitë për të mirëmbajtur qelitë e tyre në gjendje të mirë pastërtie.¹⁶

Madhësia e qelisë dhe shkalla e popullimit të tyre janë çështje shumë të rëndësishme për shkak se mbipopullimi në burgje “mund të jetë i tillë që të jetë në vetvete çnjerëzor dhe formë poshtëruese nga pikëpamja fizike.”¹⁷ Sa i përket shkallës së popullimit, Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së rekomandojnë që të paraburgosurit të vendosen në qeli individuale.¹⁸ Rregullat evropiane për burgjet po ashtu përcaktojnë që të paraburgosurit strehohen gjatë natës në qeli individuale “përveçse kur është e dëshirueshme që ata të ndajnë hapësirën për fjetje.”¹⁹

Nuk ekzistojnë udhëzime të qarta për madhësinë e qelive edhe pse KPT-ja ka ofruar udhëzime të caktuara nëpërmjet raporteve për vendet.²⁰ Për shembull, një qeli për një person në përmasa

¹⁴ Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, *Mamedova kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 7064/05, 23 tetor 2006, paragrafi 63.

¹⁵ Rregullat Evropiane të Burgut, paragrafi 6.

¹⁶ Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti për Andorën 1, paragrafi 39 (2000).

¹⁷ Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm për Aktivitetet e KPT-së, paragrafi 46 (1992).

¹⁸ Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së, paragrafi 9(1).

¹⁹ Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 18.5.

²⁰ Udhëzimet e caktuara nga ana e KPT-së dhe ato të caktuara nga organizatat apo institucionet tjera mund të dallojnë pak. Për shembull, rregullorja e UNMIK-ut 2004/46 *Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale* të datës 19 Nëntor 2004 thekson “[L]okalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra kub hapësirë dhe sasi të mjaftueshme të drithës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.” Ligji mbi

6 m² dhe 7 m² përshkruhet si e përshtatshme²¹, 8 m² si e arsyeshme,²² dhe 9 m² si madhësi e mirë e qelisë për një person.²³ Qelia në përmasën e 9 m² për dy persona përshkruhet si e ngushtë²⁴ dhe 11-12 m² si e duhur.²⁵ KPT-ja rekomandon që duhet të ketë minimum 4 m² për të paraburgosurit në një qeli për shumë persona.²⁶ Largësia ndërmjet mureve duhet të jetë së paku 2 m.²⁷ Të paraburgosurve duhet t'iu sigurohet një krevat, shtresat dhe mbulesat që “duhet të ndërrohen aq shpesh sa për të siguruar pastërtinë e tyre.”²⁸

b) *Higjiena*

Të paraburgosurit duhet të bëjnë dush së paku dy herë në javë, mundësish një herë në ditë.²⁹ Autoritetet e burgut duhet t'iu sigurojnë të paraburgosurve produktet higjenike dhe materialet sanitare që ju mundësojnë atyre pastrimin e qelive të tyre.³⁰ Ata po ashtu duhet të sigurojnë produktet sanitare për nevojat e të paraburgosurave femra.³¹

c) *Ushqimi dhe uji*

Të paraburgosurve duhet t'iu sigurohen tri shujta në ditë.³² Ushqimi duhet të “përbajë vlera ushqyese, duhet të jetë i përshtatshëm për shëndetin dhe fuqinë, duhet të jetë i cilësisë së shëndetshme dhe duhet të jetë i përgatitur mirë dhe i shërbyer mirë.”³³ Uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion gjatë tërë kohës.³⁴

d) *Shërbimet mjekësore*

Nga autoritet e burgut kërkohet të sigurojnë “kujdes shëndetësor për të burgosurit nën kujdestarinë e tyre”.³⁵ Sipas paragrafit 22 të Rregullave të Standardeve Minimale të OKB-së, secili objekt paraburgimi duhet të ketë qasje në shërbimet e një zyrtari mjekësor të kualifikuar. Përveç kësaj, të paraburgosurit duhet të kenë qasje në kujdesin psikiatrit apo

Ekzekutimin e sanksioneve penale e datës 22 Korrik 2010, thekson “[L]okalet në të cilat personi i dënuar jeton dhe punon duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra kub hapësirë, kur është e mundshme katër (4) metra kub për të burgosur në qelinë e përbashkët dhe nëntë(9) metra kub për qelitë me një shtrat dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexicim, ngrohje dhe ajrosje.” Megjithatë, pasi që KPT-ja ka prodhuar një organ më të tërësishëm të parimeve të punës në lidhje me monitorimin e burgjeve, dhomave të ndalimit policor dhe institucioneve shtetërore, OSBE-ja i referohet udhëzimeve sa i përket madhësisë së qelive.

²¹ Shih për shembull Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar gjatë vizitës në Irlandën Veriore, parografi 71 (2001); Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti për Portugalinë 1, parografi 102 (1994).

²² Shih për shembull Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Raporti për Gjermaninë 1, parografi 85 (1993).

²³ Shih për shembull Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Raporti për Mbretërinë e Bashkuar 3, parografi 111 (2000).

²⁴ Shih për shembull Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Raporti për Islandën 1, parografi 87 (1994).

²⁵ Shih për shembull Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Raporti për Mbretërinë e Bashkuar 3, parografi 111(2000), Raporti për Mbretërinë e Bashkuar (Irlandën Veriore) 2, parografi 71 (2001).

²⁶ Shih për shembull Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Raporti për Bullgarinë 5, paragrafët 77 dhe 90 (2008).

²⁷ Shih për shembull Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Raporti për Islandën 1, parografi 69 (1994).

²⁸ Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së, parografi 19.

²⁹ Rregullat Evropiane për Burgjet, parografi 19.4.

³⁰ Po aty, parografi 19.6.

³¹ Po aty, parografi 19.7.

³² Po aty, parografi 22.4.

³³ Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së, parografi 20(1).

³⁴ Rregullat Evropiane për Burgjet, parografi 22.6.

³⁵ Po aty, parografi 39.

kujdesin dentar. Sipas KPT-së një shërbim i duhur shëndetësor mund “të ketë ndikim pozitiv në cilësinë e përgjithshme të jetës brenda objektit të së cilit funksionon.” Për më tepër, dështimi i institucioneve për të siguruar kujdes të duhur mjekësor mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe poshtërues, siç edhe është vërtetuar nga GjEDNj kur ka vendosur se institucionet duhet të garantojnë shëndetin dhe mirëqenien e të paraburgosurve, duke siguruar “ndihmën e nevojshme mjekësore.”³⁶

e) Regjimi i duhur i aktiviteteve

Autoritet e burgut kanë për detyrë që të sigurojnë që të paraburgosurit kanë mundësi të ndryshojnë dhe zhvillohen. Reformimi dhe rehabilitimi social që çon në riintegrimin e të paraburgosurve në shoqëri përfshin, ndër të tjera, një program të aktiviteteve për arsim, trajnim profesional, aktivitete rekreative dhe kontaktet me botën e jashtme. Ky program i aktiviteteve u mundeson të paraburgosurve zhvillimin e shkakhtësive dhe njohurive të reja, dhe u mundeson mbajtjen e kontaktit me botën e jashtme që do t’iu ndihmon atyre të ri-integrohen në shoqëri si qytetarë që respektojnë ligjin. Është e rëndësishme të theksohet që programi i aktiviteteve, përfshirë edhe punën, duhet të jetë në dispozicion për personat e dënuar dhe personat e paraburgosur pasi që “të burgosurit nuk mund thjesht të lihen të vuajnë me javë, ndoshta edhe me muaj, të myllur në qelitë e tyre pa marrë parasysh se sa të mira janë kushtet materiale brenda qelisë.”³⁷

Puna në burg duhet të vështrohet si “një element pozitiv i regjimit të burgut.”³⁸ Nga të gjithë personat e dënuar që janë nën moshën e pensionimit “mund të kërkohet të punojnë, varësisht prej gjendjes së tyre fizike dhe mendore që përcaktohet nga eksperti mjekësor.”³⁹ Personat që presin gjykimin po ashtu duhet të kenë mundësinë për të punuar.⁴⁰ Nga autoritetet e burgut kërkohet të sigurojnë punë të mjaftueshme të natyrës së dobishme, që do të sigurojë apo shtojë mundësitë e punësimit pas lirimt nga paraburgimi.⁴¹ Puna nuk duhet të jetë “e natyrës së mundimshme”,⁴² dhe të paraburgosurit duhet të paguhen në mënyrë të drejtë për punën e tyre.⁴³

Për të njëjtat arsy, autoritetet e burgut duhet të sigurojnë trajnime profesionale, posaçërisht për të paraburgosurit në moshë të re.⁴⁴ Personat e paraburgosur po ashtu duhet të përfitojnë nga programet gjithëpërfshirëse arsimore që përmbushin kërkzesat e tyre.⁴⁵ Prioritet duhet t’iu jepet personave të paraburgosur analafabet apo që kanë mungesë të trajnimeve themelore apo profesionale, ndërsa vëmendje e veçantë duhet t’iu kushtohet të paraburgosurve në moshë të re apo të paraburgosurve me nevoja të veçanta.⁴⁶ Këto programe arsimore duhet të integrohen

³⁶ Shih për shembull paragrafin 94 të Kërkesës Nr. 30210/96 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lëndën *Kudla kundër Polonisë*, të datës 26 tetor 2000.

³⁷ Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm për Aktivitetet e KPT-së, parografi 47 (1991).

³⁸ Rregullat Evropiane për Burgjet, parografi 26.1.

³⁹ Po aty, parografi 105.2.

⁴⁰ Po aty, parografi 100.1.

⁴¹ Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së, parografi 71.4, Rregullat Evropiane për Burgjet, parografi 26.2.

⁴² Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së, parografi 71.1.

⁴³ Po aty, parografi 76.1.

⁴⁴ Po aty, parografi 71.5, Rregullat Evropiane për Burgjet, parografi 26.5.

⁴⁵ Rregullat Evropiane për Burgjet, parografi 28.1.

⁴⁶ Po aty, paragrafet 28.2 dhe 28.3.

në sistemin kryesor arsimor në mënyrë që të mundësohet arsimimi i mëtutjeshëm i të paraburgosurve pas lirimit të tyre.⁴⁷

Autoritetet e burgut po ashtu duhet të sigurojnë aktivitete të mjastueshme rekreative, përfshirë aktivitete sportive, lojëra dhe aktivitete kulturore, dhe aktivitete tjera të kohës së lirë.⁴⁸ Të paraburgosurve duhet t'iu lejohet për çdo ditë së paku një orë ushtrim në ambient të hapur.⁴⁹

Të paraburgosurve duhet t'iu lejohen kontaktet me botën e jashtme, d.m.th. atyre duhet t'iu mundësohet komunikimi me familjet dhe miqtë e tyre. Paragrafi 24.4 i Rregullave Evropiane për Burgjet përcakton që të paraburgosurve “duhet t'iu lejohet mbajtja dhe zhvillimi i marrëdhënieve familjare në mënyrën sa më normale që është e mundur.” Të paraburgosurve duhet t'iu lejohet informimi lidhur me çështjet publike përmes leximit të gazetave dhe publikimeve tjera, dëgjimit të radios dhe shikimit të televizionit.⁵⁰

Po ashtu, institucionet duhet të sigurojnë respektimin e lirisë fetare. Sipas paragrafit 29.2 të Rregullave Evropiane për Burgjet, të paraburgosurve duhet t'u lejohet që “të praktikojnë fenë e tyre dhe ndjekin besimet e tyre, të marrin pjesë në shërbimet apo takimet e udhëhequra nga përfaqësuesit e fesë apo besimit të tyre, të vizitohen privatish nga përfaqësuesit e besimit apo fesë së tyre, dhe të kenë në posedim libra apo literaturë në lidhje me besimin apo fenë e tyre.”

Në mënyrë që të përmbushen kërkesat arsimore dhe rekreative të të paraburgosurve, qendrat e paraburgimit duhet të kenë biblioteka të furnizuara mirë. Paragrafi 40 i Rregullave të Standardeve Minimale të OKB-së përcakton që “secili institucion duhet të ketë një bibliotekë për shfrytëzim nga të gjitha kategoritë e të paraburgosurve, që është e furnizuar mirë me libra rekreativ dhe mësimor dhe të paraburgosurit duhet të inkurajohen të shfrytëzojnë atë.” Kërkesa që secili institucion duhet të ketë një bibliotekë të furnizuar mirë është e përcaktuar me nenin 28.5 të Rregullave Evropiane për Burgjet. Libraritë që nuk janë të furnizuara mirë dhe që nuk përmbushin kërkesat e të paraburgosurve janë pengesë serioze për riintegrin e tyre të suksesshëm në shoqëri. Këto kërkesa nuk përfshijnë vetëm librat mësimorë që u mundësojnë të paraburgosurve fitimin e njohurive dhe shkathësive të reja, por edhe librat rekreativë, librat për administrimin e drejtësisë, për të drejtat e njeriut dhe çështjet tjera që janë të rëndësishme për të paraburgosurit dhe që ndihmojnë në zhvillimin e tyre personal, dhe që iu ndihmojnë atyre të përballen me realitetin e jetës në burg.

f) Disiplina dhe Ndëshkimet

Sipas paragrafit 27 të Rregullave të Standardeve Minimale të OKB-së, “disiplina dhe rendi duhet të ruhen me vendosmëri por me jo më tepër kufizim se sa që është e domosdoshme për sigurinë në paraburgim dhe një jetë komunitare të rregulluar mirë.” Në objektet e paraburgimit duhet të përcaktohet një procedurë disiplinore që siguron të drejtën e të paraburgosurve për qenë të informuar mirë mbi shkeljet e mundshme disiplinore, për të mbrojtur veten dhe për të parashtruar ankesë tek një shkallë më e lartë kundër ndëshkimeve të shqiptuara.⁵¹ Paragrafi 31 i Rregullave të Standardeve Minimale të OKB-së dhe paragrafi 60.3 i Rregullave Evropiane për Burgjet ndalon ndëshkimin trupor, ndëshkimin duke vendosur të

⁴⁷ Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së, paragrafi 77(2), Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 28.7.

⁴⁸ Po aty, paragrafi 78, Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 27.5.

⁴⁹ Po aty, paragrafi 21 (1), Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 27.1.

⁵⁰ Po aty, paragrafi 39, Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 24.10.

⁵¹ Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm për Aktivitetet e KPT-së, paragrafi 55 (1991), Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafët 57.2 dhe 59.

paraburgosurin në qeli pa dritë, dhe të gjitha ndëshkimet mizore, çnjerëzore apo poshtëruese për shkak të shkeljeve disiplinore.

g) Ankesat

Të paraburgosurit duhet të gëzojnë të drejtën për të parashtruar kërkesa apo ankesa tek autoritetet e burgut. Çdo personi të paraburgosur duhet t'i lejohet "parashtrimi i kërkësës apo ankesës, pa censurim të përbajtjes por në mënyrë të duhur, tek administrata qendrore e burgut, autoritetet gjyqësore, apo çfarëdo mënyre tjeter të duhur nëpërmjet kanaleve të miratuarë."⁵² KPT është i mendimit që institucionet duhet të vendosin një sistem efektiv të procedurave ankimore dhe inspektive si një lloj mbrojtje kundër trajtimit jo të mirë. Sipas KPT, të paraburgosurit duhet të kenë "rrugë të hapura brenda dhe jashtë kontekstit të sistemit të burgut, përfshirë mundësinë për të pasur qasje konfidenciale tek autoritetet përkatëse."⁵³

IV. Vlerësimi

1. Faza e parë: vizitat njohëse

Në mars 2009, OSBE-ja ka filluar monitorimin e kushteve në qendrat e paraburgimit të Kosovës. Nga 2 deri më 6 mars 2009, OSBE-ja ka kryer vizita fillestare në të gjitha qendrat e paraburgimit dhe qendrat korrektuese në Kosovë.⁵⁴ Qëllimi i fazës së parë ka qenë vendosja e kontakteve me institucionet përkatëse dhe marrja e një vështrimi të përgjithshëm për kushtet në objektet e paraburgimit.

Drejtorët e të gjitha qendrave të paraburgimit/korrektuese në Kosovë⁵⁵ kanë mirëpritur angazhimin e OSBE-së në këtë fushë dhe kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe transparencë për të gjitha fazat e projektit për monitorimin e paraburgimit.

Në përgjithësi, në shikim të parë, kushtet e objekteve të paraburgimit duken të kënaqshme. Megjithatë disa qendra të vjetra të paraburgimit, të ndërtuara në vitet 1960, kanë mungesë të hapësirës dhe disa qeli nuk kanë ndriçim të mjaftueshëm natyror apo qarkullim të ajrit.⁵⁶ Këto qendra më të vjetra të paraburgimit zakonisht janë ndërtuar në qendër të qytetit, ndërmjet stacionit të policisë dhe ndërtesës së gjykatës. Për këtë arsy, zgjerimi i këtyre qendrave të paraburgimit do të ishte i vështirë dhe nuk është variant real.

Ndryshe nga pjesa dërmuese e objekteve të paraburgimit në Kosovë, qendra e paraburgimit në Lipjan/Lipljan nuk përballet me probleme të hapësirës. Megjithatë, kjo është qendra e vetme e paraburgimit ku kanë ndodhur rastet e vetëvrasjeve dhe tentim vrasjeve në vitin 2008 dhe 2009. Rrjedhimisht, drejtori i qendrës së paraburgimit në Lipjan/Lipljan ka vendosur që t'i vendos tre të paraburgosur në një qeli, ndonëse ka hapësirë vetëm për dy persona në një qeli. Sipas drejtorit, më shumë të paraburgosur në një qeli do ta shtonte kontrollin shoqëror dhe do

⁵² Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së, paragrafi 36(2).

⁵³ Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm për Aktivitetet e KPT, paragrafi 54 (1991).

⁵⁴ Pasi që Qendra Korrektuese në Srekovicë/Smrekovnica është hapur në vitin 2010, ajo nuk është e përfshirë në këtë raport.

⁵⁵ Kosova ka qendra të paraburgimit (për paraburgim dhe për personat e dënuar që vuajnë dënimin deri në tri muaj) në Gjilan/Gnjilane, Prishtinë/Priština, Prizren, Lipjan/Lipljan, Pejë/Peć, dhe Mitrovicë/Mitrovica veriore. Qendra Korrektuese në Dubravë/Dubrava është i vetmi objekt korrektues në Kosovës për meshkujt e rritur (për personat e dënuar që vuajnë dënimin për më shumë se tri muaj dhe dënimë afatgjata). Në Lipjan/Lipljan është qendra e korrektuese përfshirë femrat dhe të mitur (për personat e paraburgosur dhe personat e dënuar).

⁵⁶ Gjilan/Gnjilane, Prishtinë/Priština, Prizren.

të mundësonë zvogëlimin e numrit të tentim vrasjeve. Megjithatë, duhet gjithashtu të kërkojen masa shtesë, siç është trajtimi i përmirësuar psikologjik, për të zvogëluar numrin e vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve.

Qendrat e paraburgimit në Kosovë në përgjithësi nuk janë të përshtatshme për të paraburgosurit në afat më të gjatë. Megjithatë, kryesisht për shkak të rasteve të pazgjidhura në gjykata, shumë të paraburgosur duhet të qëndrojnë më gjatë në qendrat e paraburgimit, të cilat nuk kanë hapësirë adekuate e as aktivitetet, gjë që ndikon negativisht tek mundësitë e tyre për rehabilitim.⁵⁷

Qendra e paraburgimit në Mitrovicën Veriore përballet me çështjet e caktuara për shkak të vendndodhjes së saj në zonën e banuar me serbë të Kosovës. Mungesa e personelit ndikon negativisht në sigurinë e objektit, është e vështirë të rekrutohet personeli i ri, meqë popullata e vendit nuk e mbështet institucionin që është i lidhur me institucionet e Kosovës. Për më tepër, shumë prej direktivave të pranuara nga niveli qeveritar në Prishtinë/Priština nuk përkthehen në gjuhën serbe.⁵⁸ Prandaj, personeli i qendrës së paraburgimit në Mitrovicë ende zbaton rregulloret e vjetra që janë në dispozicion në gjuhën serbe.⁵⁹

2. Faza e dytë: Vlerësimi i kushteve materiale në objektet e paraburgimit

Në fazën dytë, OSBE-ja ka bërë vlerësimin e kushteve fizike në objektet e paraburgimit më për së afërti, duke u përqendruar në çështjet siç janë madhësia dhe kapaciteti i qelive, ventilimi, ndriçimi, dushi dhe tualetet.

Gjatë vizitave vlerësuese, të gjithë drejtoret e objekteve të paraburgimit dhe zyrtarët korrektues ishin shumë kooperativë, duke lejuar qasjen e OSBE-së në të gjitha pjesët e objekteve të tyre. Si në mënyrë spontane dhe kurdo që kërkohej, ata ofronin informata shtesë lidhur me çështjet operacionale. Është me rëndësi të theksohet, që mangësitë më të mëdha në kushtet e objekteve të paraburgimit nuk janë shfaqur nga neglizhenca individuale e drejtoreve apo zyrtarëve, por rezulton nga mungesa sistematike që është shkaktuar kryesisht nga papërshtatshmëria fizike e mëparshme e objekteve dhe burimeve të kufizuara.

2.1 Kushtet fizike në qeli

a) Madhësia dhe kapaciteti

Në të vërtetë, shkalla e popullimit në disa objekte ishte përafersisht 70% gjatë vizitës së realizuar në gusht të vitit 2009, (p.sh. Dubravë/Dubrava 68%, Gjilan/Gnjilane 71%, Pejë/Peć 67%). Objekti më i populluar ishte në Prishtinë/Priština, që në kohën e realizimit të vizitës numëronte 64 të paraburgosur me kapacitet zyrtar për 66 të paraburgosur. Gjendja ka ndryshuar gjatë vizitave vijuese të realizuara në mars të vitit 2010, meqë shkalla e popullimit

⁵⁷ Shih gjithashtu, Seksioni për monitorimin e sistemit ligjor të OSBE-së, mbi përdorimin e paraburgimit n; procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim gjithëpërfshirek dhe analiza e brengave të mbetur, nëntor 2009 (Pjesa 1) dhe mars 2010 (Pjesa 2).

⁵⁸ Ligji për përdorimin e gjuhëve përcakton qartë që “Gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhët zyrtare të Kosovës dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës”. Shih nenin 2, Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-37 mbi përdorimin e gjuhëve, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51, 20 tetor 2006.

⁵⁹ Kjo i referohet udhëzimeve, si për shembull Procedurat Standarde të Operimit. Numri i pamjaftueshëm i dokumenteve të përkthyerë e poashtu kualiteti i dobët përkthimeve ekzistuese ndikojnë negativisht në përbushjen e tyre.

është rritur dukshëm në qendrat e paraburgimit në Pejë/Peć dhe Lipjan/Lipljan, kështu që ato ishin pothuajse plotësisht të populluara.⁶⁰ OSBE-ja është e shqetësuar se disa prej qelive nuk i plotësojnë standartet ndërkombëtare sa i përket madhësinë dhe kapacitetit. Në kohën e realizimit të vizitës, asnjeri prej objekteve nuk ka qenë i mbipopulluar lidhur me kapacitetin zyrtar. Veç kësaj, qelitë në shumë objekte janë shumë të vogla për kapacitetin për të cilin përdoren ato. Në mënyrë që të plotësohen standartet e pranuara ndërkombëtare, duhet të zgjedhesh numri i shtretërve për qeli, duke rezultuar me një shkallë përgjithësish më të ulët kapaciteti.

Sipas standardeve të KPT-së, qelitë për një person duhet të kenë madhësinë më së paku 6 m^2 . Ky nuk është rasti me qendrën e paraburgimit në Prishtinë/Priština (5.53 m^2), qendrën e paraburgimit në Gjilan/Gnjilane (5.7 m^2), qendrën e paraburgimit në Mitrovicë/Mitrovica (4.32 m^2), dhe në bllokun e qendrës korrektuese të Dubravës/Dubrava 5 (4.2 m^2). Veç kësaj, largësia ndërmjet mureve në qelitë njëshe, në disa objekte, është më pak se minimumi prej 2 m, i sugjruar nga KPT-ja. Më saktësisht, në Gjilan/Gnjilane është 1.90 m, në Mitrovicë/Mitrovica 1.45 m, në bllokun 5 të qendrës korrektuese në Dubravë/Dubrava është 1.79 m, në bllokun 2 është 1.75 m dhe në Pejë/Peć është 1.60 m.

Qelitë për dy persona me madhësi 9 m^2 definoohen nga KPT-ja si të ngushta dhe ato që kanë madhësi $11\text{-}12\text{ m}^2$ si adekuate. Në Mitrovicë/Mitrovica, qelitë që kanë dy shtretër janë përafërsisht 6.3 m^2 , ndërsa largësia ndërmjet mureve është 1.82 m. Në Prizren, në Krahun D, qelitë për dy persona janë 8.12 m^2 .

Gjithashtu, qelitë për disa persona në disa objekte nuk e plotësojnë kërkuesin prej më së paku 4 m^2 për person: Pejë/Peć (4 persona / 12.86 m^2), Mitrovicë/Mitrovica (4 persona / 8.23 m^2), Prishtinë/Priština (6 persona / 21.4 m^2), Gjilan/Gnjilane (6 persona/ $15\text{-}18\text{ m}^2$), Prizren (4 persona/ $10.86\text{-}13.48\text{ m}^2$), Dubravë/Dubrava blloku 2 (6 persona/ 19.87 m^2), Dubravë/Dubrava blloku 3 (4 persona / 13.74 m^2 , 6 persona- 20 m^2), Dubravë/Dubrava blloku 4 dhe 5 (4 persona / 11.5 m^2 , 6 persona / 19.3 m^2), Dubravë/Dubrava blloku 7 (8 persona / 16.48 m^2).⁶¹

Siqë është paraqitur më lartë, madhësia dhe kapaciteti joadekuat i qelive është problematik në pjesën dërmuese të objekteve. Vetëm objektet në Lipjan/Lipljan dhe blloqet 1, 6, 8 dhe 10⁶² në Dubravë/Dubrava ofrojnë hapësirë adekuate. Megjithatë, këto objekte përballen me probleme tjera, të cilat do të pëershkuhen më poshtë.

b) Ndriçimi, ventilimi dhe nxehja

Në përgjithësi, ka ndriçim dhe ventilim adekuat pothuajse në të gjitha objektet. Qelitë janë të ajrosura sa duhet dhe ndriçimi natyror dhe artificial është i mjaftueshëm ashtu që të paraburgosurit të janë në gjendje të lexojnë. Megjithatë, në Pejë/Peć nuk ka ndriçim të mjaftueshëm për lexim, ndërsa ventilimi nuk është adekuat gjatë muajve të verës në qendrën e paraburgimit në Prishtinë/Priština⁶³ dhe në Dubravë/Dubrava në blloqet 4, 5, 6 dhe 7. Kur OSBE-ja ka vizituar këto objekte në gusht 2009, qelitë kanë qenë të mbingarkuara. Ky problem është rënduar edhe më shumë me mbipopullimin nëpër qeli. Për shembull, kushtet e jetesës ishin të pakënaqshme në qelitë me madhësi 21.4 m^2 në Prishtinë/Priština, ku ishin të

⁶⁰ Gjatë diskutimeve në punëtorinë e datës 24 Shtator 2010, ku drafti i këtij raporti ishte diskutuar me Shërbimin Korrektues të Kosovës, OSBE-ja ishte informuar se shkalla e përgjithshme e popullimit është zgjedhur, pjesërisht për shkak të hapjes së qendrës korrektuese në Smrekovnicë/Smrekovica.

⁶¹ Shih shtojcën 2 për hartën ku paraqiten hollësitë për madhësinë dhe kapacitetin e qelive në të gjitha objektet.

⁶² Blloku 10 është i gjysëm hapur, i ndarë nga blloqet tjera.

⁶³ Gjatë vizitës në Tetor të vitit 2010, OSBE-ja vërejti se sistemi i ventilimi në qendrën e paraburgimit në Prishtinë/Pristina është irregulluar.

vendosur gjashtë të paraburgosur gjatë vizitës sonë në muajin gusht. Me vetëm 3.5 m^2 për person, mot shumë të nxeh të dhe ventilim joadekuat, kushtet në qeli janë shumë të pakëndshme.

Ngrohja funksionon në të gjitha objektet pa ndonjë vështirësi të madhe. Megjithatë, disa drejtorë kanë theksuar se kanë kufizime financiare lidhur me sigurimin e lëndës djegëse, gjë që ka ndikuar në kushtet e disa qelive. Gjatë vizitës së realizuar në mars të vitit 2010, qendra e paraburgimit në Mitrovicë përballej me problemin e lëndës djegëse për sistemin e ngrohjes. Në vend të tridhjetepesë tonëve naftë të kërkua, ata kanë pranuar vetëm tetë tonë, që nuk ishte e mjaftueshme për nevojat e tyre. Ngrohja në Dubravë/Dubrava, në blloqet 5 dhe 7 mund të përmirësohet, meqë sipas të paraburgosurve, qelitë nuk janë mjaft të ngrohta gjatë dimrit.

Sipas drejtorit të qendrës së paraburgimit në Prishtinë/Priština, të paraburgosurit ishin ankuar për shkakun se në qeli ishte shumë nxeh të gjatë verës dhe shumë ftohtë gjatë dimrit. Në mënyrë që kjo të tejkalojet, kulmi i kësaj qendre ishte renovuar në vitin 2010. Izolimi i dyfishtë i kulmit është një përmirësim i konsiderueshëm.

c) Kushtet sanitare

Në përgjithësi objektet janë shumë të pastra. Menaxhmenti i qendrave të paraburgimit meriton lëvdata në përpjekjet e tyre për mirëmbajtjen e nivelit të lartë të higjenës. Gjatë vizitave, qelitë, korridoret, zyrat, dhe objektet e jashtme ishin shumë të pastra dhe të mbajtura mirë. Gjithashtu vlen të theksohet, që kuzhinat në të gjitha objektet ishin veçanërisht të mirëmbajtura.

Tualetet në disa blloqe të qendrës korrektyuese të Dubravës/Dubrava dhe qendrën për të mitur në Lipjan/Lipljan janë përjashtim negativ, i cili do të diskutohet më në hollësi më poshtë.

d) Çështjet e veçanta që ndikojnë në objekte

Qendra e paraburgimit në Lipjan/Lipljan

Ndonëse, madhësia dhe kapaciteti i qelive në qendrën e paraburgimit në Lipjan/Lipljan ishin të kënaqshme, lartësia e tavanit në përdhes ishte vetëm 2.39 m, gjë që të jepte përshtypjen e një hapësire shumë ngulfatëse. E tërë ndërtesa ishte e ngjyrosur me të hirtë e cila, e shoqëruar me tavanin e ultë, e bënte ndërtësën të dukej shumë e ngrysur dhe ngulfatëse. Në kuptimin pozitiv, sa i përket gjendjes, ndriçimi natyror dhe artificial, ventilimi dhe kushtet fizike ishin shumë të mira.

Sic është përmendur në kapitullin IV, drejtori i qendrës së paraburgimit në Lipjan/Lipljan ka marrë vendim që t'i vendos tre në vend të dy të paraburgosurve në një qeli, pas shfaqjes së vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve në vitin 2008 dhe 2009. Kjo është ndërmarrë për të përmirësuar sigurinë për të paraburgosurit vetëvrasës përmes kontaktit më të madh shoqëror dhe si rrjedhojë, kontrollin shoqëror. Që nga koha kur ka filluar të aplikohet kjo qasje, nuk është raportuar për asnjë rast të vetëvrasjes. Në anën tjetër, tre të paraburgosur janë vendosur në qelinë për dy persona, gjë që ka rezultuar me më pak hapësirë për të paraburgosurit. Sipas drejtorit, të paraburgosurit, përkizazi e mirëpritën këtë hap, meqë qelia kishte hapësirë të mjaftueshme për masën e tillë të ndërmarrë.

Gjatë vizitës në Tetor të vitit 2010, drejtori i qendrës së paraburgimit në Lipjan/Lipljan e informoi OSBE-në se qysh nga kohët e fundit, të paraburgosurit dhe personat e dënuar qëndrojnë në krahe të ndara. OSBE-ja përgëzon këtë vendim.⁶⁴

Qendra korrektuese në Lipjan/Lipljan

Kushtet materiale ishin veçanërisht të këqija në objektin për të mitur në Lipjan/Lipljan, në kohën kur e kemi realizuar vizitën e parë në gusht të vitit 2009. Qelitë kishin madhësi të mirë me madhësi rrëth 24.9 m^2 për gjashtë persona. Megjithatë, nuk kishte tualet brenda qelisë. Dushet dhe tualetet ekzistuese, nuk ishin në gjendje të mirë, kutëbonin gjatë kohës së vizitës. Çdo gjë, duke filluar nga muret, dyshemetë deri te mobilet ishin të vjetruara dhe shkatërruara, duke krijuar një atmosferë të zymtë. I tërë objekti për të mitur ishte shumë i rrënuar dhe kishin nevojë urgjente për renovim. Veç kësaj, transformatori i tensionit të lartë i lidhur me bllokun D paraqiste rrezik për siguri.

Duke marrë parasysh që të miturit në paraburgim kërkojnë trajtim të veçantë dhe të individualizuar si dhe mjedis motivues për ta mundësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri, kushtet materiale në objektin për të mitur janë veçanërisht problematike. Atmosfera e zymtë dhe gjendja dëshpëruese nuk ofrojnë mjedis të përshtatshëm për të miturit.

Gjatë vizitës në mars të vitit 2010, sapo kishte filluar renovimi i dy blloqeve të objektit për të miturit, e që ishte një hap pozitiv drejt përmirësimit të kushteve të përgjithshme. Qysh nga muaji Tetor i vitit 2010, blloku A ishte renovuar tërësisht. Renovimet në blloku B nuk kishin filluar ende. Kushtet materiale në ndërtesat tjera siç është shkolla, objekti i brendshëm sportiv dhe qendra për zhvillim profesional janë shumë të mira. Ndonëse, deri më tanë nuk është marrë asnjë hap sa i përket transformatorit të tensionit të lartë.

Kushtet fizike në objektin e femrave ishin shumë të mira, veçanërisht ndriçimi, ventilimi, mobilet, dekorimet dhe gjendja e përgjithshme. Menaxhmenti meriton të lavdërohet për përpjekjet e tyre për pajisjen e objektit për nëna dhe foshnje.

Ambulanca e cila mbulon të dyja pjesët atë të femrave dhe të miturve ishte renovuar tërësisht në vitin 2010. OSBE-ja vëzhgoi në muajin Tetor të vitit 2010 se pasjisja e ultrazërit ishte dëmtuar, e cila si pasojë kishte transportimin e femrave të kësaj qendre të cilat kanë nevojë për kontrolla me ultrazë, në ambulancat dhe spitalet tjera. Një pajisje e tillë është esenciale për qendrën korrektuese të femrave dhe duhet të ndërrohet sa më shpejt që është e mundshme.

Qendra korrektuese e Dubravës/Dubrava

Kushtet në qendrën korrektuese të Dubravës/Dubrava ndryshojnë shumë. Për shembull, kushtet materiale janë të mira në blloku 6 dhe në blloku 8 të posa rinouar. Qelitë kanë madhësi adekuate, ndriçim dhe ventilim të mirë, të mobiluara përshtatshëm, tualete dhe lavaman të ndarë. Megjithatë, kompania e cila ka bërë renovimin e bllokut 8 nuk i ka instaluar bravat si duhet; disa prej tyre nuk funksionojnë fare. Gjithashtu, kablloja e tensionit të lartë paraqiste rrezik në dhomën e përbashkët kur OSBE-ja vizitoi objektin në muajin Mars të vitit 2010. Ky problem është zgjidhur tashmë.

Në anën tjetër, kushtet fizike nuk janë aq të mira sikurse në blloqet tjera. Për shembull, qelitë në blloku 4 dhe 5 janë shumë të vogla për kapacitetin për të cilin shfrytëzohen, dhe renovimi

⁶⁴ Sipas Standardeve minimale të rregullave të KB-së, paragrafi 85(1) “ [P]ersonat e pagjykuar duhet të ndahen nga ata të dënuar.”

dhe riparimet janë mesatare krahasuar me kushtet materiale në bllokun 6. Rrjedhjet e ujit shkaktojnë probleme shtesë në korridore dhe qeli të blloqeve 3, 4, 5 dhe 7.⁶⁵ Qelitë në bllokun 7 nuk janë të pajisura me karrige e madje as me tavolina dhe të mbipopulluara me vetëm 2 m² hapësirë për një të paraburgosur dhe 8 persona për qeli.⁶⁶ Siç është përmendur më lartë, çështje problematike në blloqet 2, 3, 4 dhe 5 është mbipopullimi.

Një çështje tjetër që paraqet arsyet për brengosje është gjendja e tualetave dhe dusheve. Gjatë vizitës tonë, ndërtesat në përgjithësi, duke përfshire qelitë ishin shumë të pastra, ndërsa tualetet dhe dushet nuk ishin. Pjesa dërmuese e tyre kishin mbeturina në dyshemë; disa prej tyre kutëbonin (blloqet 4 dhe 10); kokat e dusheve mungonin në bllokun 2 dhe 3; një dash nuk punonte në bllokun 1; dhe, dushet në blloqet 4, 6 dhe 10 ishin mbuluar me myk. Veç kësaj, dritaret nuk mund të hapeshin në tualete dhe dushe në bllokun 6, dhe nuk kishte ventilim fare. Meqë blloku 6 ishte më lartë se blloqet tjera, presioni i ujit ishte i ultë.

Pjesët e blloqeve 3, 4, 5 dhe 10 ishin mbuluar me myk, jo vetëm tualetet dhe dushet, por edhe disa prej qelive, korridoreve, pjesë të dyshemesë dhe tavanit. Prania e mykut është shumë shqetësuese, meqë mund të paraqesë rezik shëndetësorë.

2.2 Ushqimi dhe uji

Sipas informatave të marra përmes intervistave të zhvilluara me drejtoret ose me personelin e caktuar, të paraburgosurit kanë qasje në ujë të pijshëm në të gjitha objektet gjatë tërë kohës. Të paraburgosurit shërbehen me tri shujta në ditë. Personeli mjekësor e kontrollon ushqimin dhe vlerat ushqyese. Ushqim i njëjtë i shërbehet personelit të paraburgimit dhe atij menaxhues. Menaxhmenti duhet të çmohet për përpjekjet e tyre, në sigurimin e shërbimit të paraburgosurve me shujta cilësore të ushqimit, përkundër shtrëngimeve buxhetore.

2.3 Bibliotekat

Gjatë vizitës në gusht 2009, e vetmja bibliotekë që i plotësonte nevojat e të paraburgosurve ishte ajo në Qendrën Korrektuese për të miturit në Lipjan/Lipljan. Qendra kishte pranuar një donacion të mirëpritur nga UNICEF-i. Ndërtesat tjera kishin shumë nevojë për libra. Në shumicën e rasteve, “bibliotekat” përbëheshin nga një raft që mbante disa libra të vjetra që nuk i plotësonin nevojat arsimore dhe rekreative të paraburgosurve. Situata ishte veçanërisht e keqe në qendrën korrektuese në Dubravë/Dubrava, i cili e kishte një dhomë të plotë të caktuar si bibliotekë. Mirëpo, diku dy të tretat e rafteve ishin plotësish të zbrazëta derisa të tjerat ishin të mbushura me libra të dala nga moda dhe shumë të vjetra. Sipas menaxhmentit të qendrës korrektuese, shumë të paraburgosur e kishin shprehur dëshirën e tyre për të lexuar, por ofertat e librave në bibliotekë ishte shumë e kufizuar.

Për të përmirësuar situatën, në tetor të vitit 2009, OSBE-ja ka dhënë si donacion afërsisht 1.200 libra, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë serbe, Shërbimit Korrektues të Kosovës për t’iu ndihmuar objekteve të paraburgimit dhe atyre korrektuese që të përmbushin standartet relevante të të drejtave të njeriut dhe ligjet e aplikueshme, si dhe të përmirësojnë kushtet për personat që mbahen në to. Donacioni përfshinte libra udhëzues, që iu mundësojnë të burgosurve që të fitojnë njojuri dhe shkathtësi të reja, poashtu libra për rekreacion, fjalorë, libra për administratën dhe drejtësinë, të drejtat e njeriut dhe çështje tjera që ishin relevante për të paraburgosurit.

⁶⁵ Çështja e rrjedhjes së ujit është përmirësuar në bllokun 5.

⁶⁶ Kushtet në bllokun 7 janë përmirësuar që nga atëherë. Në vend të tetë, tanë vetëm katër persona zënë një qeli.

2.4 Vendet e hapura për ushtrime

Të gjitha objektet kanë vendet e hapura për ushtrime dhe zakonisht ofrojnë mundësinë për aktivitete tjera përvèç ecjes, si pajisjet për pingpong. Disa nga vendet e hapura për ushtrime për shembull ai në Pejë/Peć dhe Prishtinë/ Priština, kanë hapësirë shumë të kufizuar. Objektet tjera si Qendra e paraburgimit të Lipjan/Lipljan dhe Dubravë/Dubrava kanë vende të mëdha të hapura për ushtrime, të cilat iu mundësojnë të paraburgosurve që të merren me sport. Disa objekte tjera kanë gjithashtu fusha sportive dhe dhoma të ushtrimeve që mundësojnë një sërë aktivitetesh për të paraburgosurit. Qasja në këto vende si dhe disponueshmëria e tyre do të diskutohen në raportin tjetër. Disa vende të hapura për ushtrime ofrojnë pak apo nuk ofrojnë fare mbrojtje nga kushtet atmosferike, si ato në qendrat e paraburgimit në Pejë/Peć, Mitrovicë dhe Lipjan/Lipljan. Derisa OSBE-ja merr parasysh brengat e sigurisë lidhur me këtë çështje të ngritur nga institucionet, një zgjidhje duhet të gjendet për t'i mbrojtur të paraburgosurit nga kushtet atmosferike.

2.5 Kushtet e punës së personelit

Stafi korrektaues kryen një shërbim të rëndësishëm publik. Puna e tyre është kyçe për të siguruar rend, siguri dhe kontroll të objekteve të paraburgimit, për tu siguruar që të paraburgosurit të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe të drejtë, dhe që të drejtat e tyre të njeriut të respektohen. Për të arritur këto synime, personeli korrektaues duhet të trajnohet, motivohet dhe mbështetet. Rrjedhimisht, kushtet e mira të punës janë të nevojshme për tu siguruar që personeli korrektaues t'i ketë burimet e duhura dhe motivimin për kryerjen e detyrate të tyre.⁶⁷

Ndonëse qëllimi kryesor i këtij rapporti është vlerësimi i kushteve materiale në objektet e paraburgimit që ndikojnë tek të paraburgosurit, OSBE-ja gjatë vizitave ka vërejtur që stafi në këto objekte shpesh nuk ka kushte adekuate të punës, në veçanti sa i përket hapësirës. Për shembull në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë/Priština hapësira e ndarë për rojet është shumë e kufizuar dhe pak e mobiluar. Në qendrën korrektauese të Dubravës/Dubrava në bllokun 9 objekti i spitalit , dritaret në dhomën e personelit janë prishur që nga viti 1999, dhe aty bëhet shumë ftohtë dhe fryen era. Poashtu, radiatori në këtë bllok nuk ishte duke funksionur si duhet. Disa toalete të stafit, në veçanti në bllokun 4 ishin në gjendje shumë të keqe.

V. Perspektivat

1. Projekti i OSBE-së për monitorimin e paraburgimit i vendosur në perspektivë

OSBE-ja ka filluar monitorimin e objekteve të paraburgimit në vitin 2009. Raportet që dalin nga aktivitetet monitoruese të OSBE-së do të mund t'i shërbën shërbimit korrektaues të Kosovës si mjet për tërheqjen e financimit nga donatorët.

Derisa disa organizata joqeveritare (OJQ) dhe shtete individuale janë angazhuar në asistencën apo monitorim në Kosovë, me sa duket mungon një qasje sistematike. EULEX-i është i angazhuar përmes programit të tij të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit në qendrën korrektauese të Dubravës/Dubrava dhe në qendrën e paraburgimit në Lipjan/Lipljan. Mirëpo ata nuk janë përqendruar në çështjet e të drejtave të njeriut.⁶⁸ Qendra Kosovare për

⁶⁷ Për më tepër informata, ju lutem shihni: Coyle, A, (2002), *Qasja e të drejtave të njeriut në Menaxhimin e Burgjeve*, Qendra Ndërkombëtare për Studime të Burgjeve, Mbretëri e Bashkuar.

⁶⁸ EULEX-i është gjithashtu i përfshirë në ofrimin e përcjelljes së të burgosurve në të gjitha rajonet.

Reabilitimin e Viktimave të Torturës” (KRCT) është një nga OJQ-të vendore të përfshira në monitorimin e paraburgimit në tërë Kosovën. Mirëpo, potenciali i tyre i monitorimit është i kufizuar pasi që ata e kanë një ekip të vogël dhe u mungon personeli për punë në terren. Duke qenë e vetmja OJQ me përvojë të konsiderueshme dhe qasje sistematike, ajo është një nga OJQ-të më të rëndësishme për monitorimin e çështjeve të paraburgimit. Për të rritur qëndrueshmërinë, KRCT si dhe OJQ-të tjera profesionale vendore duhet të vazhdojnë të mbështeten si nga institucionet vendore ashtu edhe organizatat ndërkombëtare.

Institucione apo organizata tjera lokale e trajtojnë këtë çështje në baza sporadike, apo kanë qasje tjera, si Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë (IAP) apo OJQ-ja vendore “Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut”. IAP sikur shumica e institucioneve të Avokatit të Popullit, reagon në mënyrë reaktive për çështjet e paraburgimit, viziton të paraburgosurit në bazë të ankesave të parashtruara përmes kutive për ankesa të IAP-së që gjenden nëpër objektet e paraburgimit.⁶⁹ Mirëpo, në vitin 2009, IAP gjithashtu ka iniciuar vizita sporadike, proaktive në objektet e paraburgimit. Kjo duhet lavdëruar, duke pasur parasysh rolin potencial të IAP-së në Mekanizmat e ardhshëm të institucionalizuar lokal të inspektimit.

2. Qasja

Qasja në objektet e paraburgimit që janë nën shërbimin korrektues të Kosovës së paku në disa raste ka qenë çështje brengosëse. OJQ-të lokale dhe vetë OSBE-ja, nganjëherë janë përballë me vështirësi në qasjen e tyre tek të paraburgosurit për intervista. Derisa është e kuptueshme që vizitat duhet të paralajmërohen dhe koordinohen me drejtuesit e objekteve të paraburgimit, kjo procedurë duket të jetë shumë kufizuese dhe e centralizuar. Shërbimi korrektues ka qenë shumë bashkëpunues dhe i gatshëm lidhur me vizitat njofuese dhe vlerësimin e kushteve materiale nga OSBE-ja. Mirëpo, ka qenë më hezitures për sa i përket lejimit të qasjes te të paraburgosurit të cilët kanë kërkuar që të takohen me monitorues të OSBE-së. Në këto raste, drejtuesit e ndërtesave të paraburgimit kërkonin nga monitoruesit e OSBE-së që të marrin miratimin nga komesari i shërbimit korrektues për secilin rast, ndonëse një marrëveshje paraprake me komesarin parashihet lejimin e qasjes tek i paraburgosuri nëse ajo është e koordinuar me drejtuesit e atyre institucioneve. Pengesat në fitimin e qasjes tek të paraburgosurit shpien në vonesat në vizita dhe përfundimisht e kufizuan të drejtën e të paraburgosurve për të folur me përfaqësues të organizatave neutrale. Meqë një sistem më i decentralizuar i vizitave për të paraburgosurit do të krijonte barrë shtesë administrative, një mekanizëm i krijuar i monitorimit për organizatat ndërkombëtare apo lokale do të ishte më efikas.

3. Krijimi i një sistemi të institucionalizuar të vizitave në Kosovë

Në vitin 2006 ka hyrë në fuqi Protokolli Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit tjetër Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtërues (OPCAT). Që nga shkurti i vitit 2010, 50 shtete palë e kanë ratifikuar OPCAT-in, në mesin e të cilave një numër i shtetëve nga rajoni i Ballkanit,⁷⁰ të cilat tani po përpilen t'i përmbushin dispozitat e tij me përfshirje të gjërë.

Synimi i OPCAT-it është “krijimi i një sistemi të vizitave të rregullta që do të ndërmerren nga organet e pavarura ndërkombëtare dhe kombëtare në vendet ku personat privohen nga liria e tyre, në mënyrë që të parandalohet tortura dhe trajtimi apo dënim i tjetër çnjerëzor, apo

⁶⁹ IAP ka vendosur kuti në të gjitha objektet e paraburgimit në Kosovë. Vetëm personeli i IAP-it mund të ketë qasje në këto kuti për t'i lexuar letrat e vendosura nga të paraburgosurit.

⁷⁰ Ndër to Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

poshterues.”⁷¹ Përveç krijimit të Nënkomitetit për Parandalim të Torturës dhe Trajtimit dhe dënimit tjetër Mizor, Çnjerëzor apo Poshterues brenda komitetit Kundër Torturës, një nga Dispozitat kryesore të OPCAT-it është themelimi i mekanizmave nacional të parandalimit (MNP-ve). Në veçanti “secili Shtet Palë duhet të krijojë, caktojë apo mirëmbajë në nivel vendor një apo më tepër organe të vizitës për parandalimin e torturës dhe trajtimit apo dënimit tjetër mizor, çnjerëzor, apo poshterues (ne tekstin e mëtutjeshëm i referuar si mekanizëm nacional parandalues).”⁷²

OPCAT-i është mjaft fleksibil kur kemi të bëjmë me strukturën e MNP-ve. Shumica nga ata që zbatojnë dispozitat kanë qenë në favor të një qasjeje “Avokatit i Popullit plus”, pasi që ato i kanë përdorur institucionet ekzistuese (p.sh Institucionin e Avokatit të Popullit) dhe organizatat (p.sh OJQ-të që janë aktive në fushën e monitorimit të paraburgimeve) për të krijuar MNP-të. Një faktor i rëndësishëm gjatë dizajnjimit të MNP-ve është që të sigurohem që një masë e madhe e pavarësisë prekë si aspektet funksionale (financimin e duhur, vendimet për fondet, imunitetet) ashtu edhe aspektet e personelit të mekanizmit (emërimi, përbërja, dhe shkarkimi).

Institucionet e Kosovës duhet të inkurajohen që t’i zbatojnë dispozitat e OPCAT-it për MNP-të, veçanërisht sa i përket monitorimit të qëndrueshëm të paraburgimit në vend. Kjo është e një rëndësie të veçantë, kur e kemi para sysh faktin që sistemi i vizitave të rregullta në vendet ku personat privohen nga liria e tyre është element kyç për vlerësimin e respektimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga institucionet e Kosovës.

OJQ-të lokale që tashmë rregullisht kryejnë vizita në objektet e paraburgimit në Kosovë do të mund të luanin rol vital në inkurajimin e themelimit të mekanizmave vendor të monitorimit. Disa OJQ kanë filluar ngritjen e vetëdijes për këto mekanizma, në veçanti KRCT-ja, e cila ka organizuar konferenca për MNP-të gjatë vitit 2009. Gjatë dy konferencave, pjesëmarrësit nga shërbimi korrektues i Kosovës, policia, organizatat ndërkombëtare, dhe OJQ tjera mirëpritën themelimin në të ardhmen të mekanizmave lokal të inspektimit në Kosovë. Ky është një hap i vlefshëm dhe bazë që tanë duhet të forcohet. OSBE-ja për këtë qëllim ka organizuar punëtori në vitin 2010 në mënyrë që t’i sjellë së bashku ato institucione dhe organizata vendore që potencialisht do të formonin një pjesë të mekanizmit të tillë. Këto ‘takime të shkëmbimeve të ideve’ janë dëshmuar të janë shumë të dobishme, me Ombudspersonin, QKRMT-në dhe Këshillin për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, duke qenë në kryesimin e diskutimeve.

Në disa takime, drejtorët e qendrave të paraburgimit dhe korrektuese, e poashtu edhe vetë komesari ishin pajtuar me rëndësinë e krijimit të mekanizmit të tillë inspektues, sepse do të ishte i dobishëm për shërbimin korrektues sa i përket kordinimit të vizitave të ndryshme të organizatave në qendrat e paraburgimit dhe korrektuese.

VI. Konkudime dhe rekomandime

Në përgjithësi, kushtet materiale në objektet e paraburgimit janë të kënaqshme. Mirëpo, një numër i gjërave do të mund të përmirësohen, kryesisht për sa i përket madhësisë dhe kapacitetit të qelive. Kjo situatë do të mund të përmirësohej mjaft shumë duke zvogëluar numrin e personave në qeli, por duke siguruar që madhësia e tyre të jetë në përputhje me

⁷¹ Protokolli opsional i Konventës kundër Torturës dhe trajtimit dhe dënimit tjetër mizor, çnjerëzor degradues të miratuar më 18 dhjetor 2002 në seancën e 57 të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, A/RES/57/199, Pjesa 1, neni 1.

⁷² Po aty, neni 3.

standardet ndërkombejtare. Shqetësimi tjera përfshijnë ventilimin e dobët, tualetet dhe vendet e dushit jofunksionale në disa nga objektet, si dhe gjendja e dobët e riparimit të disa objekteve.

Siqështë përmendur më lart, këto objekte të ndërtuara në vitet 1960-ta nuk mund të zgjerohen për shkak të pozitës së tyre në qendrat e qyteteve dhe ndërmjet ndërtesave të gjykatave dhe policisë. Renovimi i tyre është vetëm zgjidhje afatshkurtër pasi që nuk zgjidhet problemi i hapësirës së pamjaftueshme. Renovimet sipërfaqësore, siqështë ngjyrosja e mureve dhe rregullimi i rrjedhjeve të ujtit të shkaktuara nga sistemet e vjetra të ujësjellësit, janë po ashtu përmirësimi të përkohshme. Prandaj, institucionet lokale, si strategji afatgjate, duhet të investojnë në objekte të reja të paraburgimit, në vend të renovimit të vazhdueshëm të objekteve të vjetra.

Duke pasur paraysh këtë që u tha më lart, OSBE-ja jep këto rekomandime:

1. Kushtet Materiale

- Madhësia dhe kapaciteti i qelive në shumë objekte nuk i plotëson standardet ndërkombejtare. Duhet të bëhen përpjekje për zvogëlimin e numrit të personave në qeli dhe të sigurohet që madhësia e tyre të jetë e mjaftueshme për numrin e të paraburgosurve që mbahen në të.
- Të sigurohet që ndriçimi dhe ventilimi janë adekuat në të gjitha objektet.
- Qendra e Paraburgimit në Lipjan/Lipljan është e ngjyrosur me ngjyrë hiri, gjë që e bën objektin të duhet si vend shtypës. Duhet të bëhen përpjekje që këtij objekti t'i jepet një pamje më miqësore, që do të kishte efekt pozitiv si te të paraburgosurit ashtu edhe te vetë personeli.
- Objekti për mbajtjen e të miturve në Lipjan/Lipljan është në gjendje gjysmë të shkatërruar dhe nuk ofron mjedis të përshtatshëm për të miturit. Qelitë, tualetet dhe dushet duhet të rinovohen plotësisht. OSBE-ja mirëpret renovimin e dy bloqueve të objektit ku mbahen të miturit që është planifikuar për vitin 2010. OSBE-ja do të rivlerësojë kushtet pasi të jenë përfunduar renovimet.
- Myku në qendrën korrektuese të Dubravës/Dubrava mund të shkaktojë rrezik për shëndet. Duhet të bëhen përpjekje për heqjen e mykut dhe të parandalohet paraqitja e serishme/rritja e tij.

2. Monitorimi i Paraburgimit

- Organizatat joqeveritare vendore dhe organizatat ndërkombejtare në fushën e monitorimit të paraburgimit nuk duhet të përballen me pengesa në qasjen e tyre tek të paraburgosurit. Për të siguruar këtë, shërbimi korrektues duhet të aranzhojë një sistem të decentralizuar institucional, që e respekton orarin e të paraburgosurve.
- Institucionet relevante vendore duhet të mbështesin krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm vendor për inspektim. Mekanizmi Nacional i parandalimit sipas propozimit të OPCAT-it do të mund të shërbente si shembull për këtë. Ministria e Drejtësisë dhe apo

institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë duhet të krijojnë një grup punues për këtë çështje, në përbërje të akterëve relevantë. Duhet të merren parasysh përvojat nga rajoni.

VII. Shtojca

1. Tabela e objekteve të paraburgimit⁷³

Key:

	Plotëson dhe tejkalon standardet ndërkombe të
	Mezi i pranueshëm apo në kufi nën standardet ndërkombe të
	Nuk plotëson standardet e pranueshme ndërkombe të

Qendra e Paraburgimit		Dritë natyrale	Drita artificiale	Ventilimi	Ngrohja	Tualetet	Dushet	Pastërtia sanitare	Gjendja e përgjithshme e riparimeve
Dubravë/ Dubrava	Blloku 1								
	Blloku 2								
	Blloku 3								
	Blloku 4								
	Blloku 5								
	Blloku 6								
	Blloku 7 ⁷⁴								
	Blloku 8								
	Blloku 9 Spitali								
	Blloku 10 gjy i h								
Gjilan/Gnjilane									
Qendra e paraburgimit Lipjan/Lipljan									
Lipjan/Lipljan	e të miturve								
	e femrave								
Mitrovica/Mitrovicë									
Pejë/Peć									
Prishtinë/Priština									
Prizren									

⁷³ Ju lutem vini re që tabela në vazhdim ofron një vështrim të përgjithshëm të kushteve materiale në objektet e mbajtjes. Tabela i referohet kushteve në Maj 2010 dhe nuk i merr parasysh asnjë nryshim apo renovim që nga kjo datë.

⁷⁴ Gjatë visitës në muajin Tetor të vitit 2010, OSBE-ja vërejtë se blloku 7 ishte shëndrruar në një pjesë të spitalit.

2. Tabela e paraburgimit, qelitë individuale

Qendra e paraburgimit	Bloku	Kapaciteti	Madhësia e qelisë	Metër për person
Dubravë/Dubrava	1	2	12.84	6.42
	2	1	7.00	7.00⁷⁵
		2	14.00	7.00
	3	6	19.87	3.31
		6	20.00	3.33
	4	4	13.74	3.43
		4	11.50	2.88
	5	6	19.30	3.22
		4	11.50	2.88
		1	4.22	4.22
	6	4	18.18	4.55
	7	8	16.48	2.06
	8	1	7.31	7.31
		4	15.87	3.96
	10	3	15.48	5.16
		4	20.87	5.22
		6	18.00	3.00
Gjilan/Gnjilane	6	15.00	2.50	
	1	5.70	5.70	

Qendra e paraburgimit	Bloku	Kapaciteti	Madhësia e qelisë	Metër per person
Lipjan/Lipljan	E të mitutve	2	13.87	6.93
	6	24.90	4.15	
	e femrave	2	12.20	6.10
Qendra e Paraburgimit në Lipjan/Lipljan		1	6.12	6.12
		3	15.69	5.23
		4	8.23	2.06
Mitrovica/Mitrovicë		2	6.28	3.14
		1	4.32	4.32
Pejë/Peć		1	6.56	6.56⁷⁶
		4	12.86	3.21
Prishtinë/Priština		1	5.53	5.53
		6	21.40	3.56
		4	16.42	4.10
Prizren	A	4	10.86	2.71
	1	6.24	6.24	
	4	10.86	2.71	
	4	13.48	3.37	
	C	4	10.86	2.71
D	4	13.48	3.37	
	2	8.12	4.06	
	4	11.32	2.83	
	4	16.4	4.11	

⁷⁵ Vetëm 1.75 m ndërmjet mureve.

⁷⁶ Vetëm 1.6 m ndërmjet mureve.